



Strasbourg, 17 dhjetor 2009

CEPEJ (2009) 11 REV 2

KOMISIONI EVROPIAN PËR EFIKASITETIN E DREJTËSISË  
(CEPEJ)

## **UDHËZIME PËR ZBATIM MË TË MIRË TË REKOMANDIMEVE EKZISTUESE TË KËSHILLIT TË EVROPËS MBI PËRMBARIMIN**

**Miratuar nga CEPEJ në takimin e 14-të plenar**

**(Strasbourg, 9 dhe 10 dhjetor 2009)**

### **HYRJE**

#### **Metodologjia**

1. Në Samitin e 3-të të Këshillit të Evropës (Varshavë, 6 maj 2005), Krerët e Shteteve dhe Qeverive u zotuan për të "përdorur plotësisht potencialin e Këshillit të Evropës për vendosjen e standardeve dhe për të promovuar zbatimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të instrumenteve ligjore të organizatës dhe mekanizmave të bashkëpunimit juridik". Në këtë samit, u vendos që të "ndihmohen shtetet anëtare për të dhënë drejtësi në mënyrë të drejtë dhe të shpejtë".

2. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës theksoi në tetor të vitit 2005, se përmbartimi i vendimeve gjyqësore është një element thelbësor në funksionimin e një shteti të bazuar në sundimin e ligjit. Kjo përbën një sfidë serioze si në nivel kombëtar dhe evropian (CM/Monitor (2005) 2 nga 14 tetor 2005)

3. Kjo deklaratë, e konfirmuar nga praktika gjyqësore përkatëse e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), dhe problemet në zbatimin e vendimeve të saj, si dhe puna e CEPEJ e ka shtyrë Komitetin e Ministrave të dedikojnë një proces monitorimi për përmbartimin e vendimeve gjyqësore kombëtare. CEPEJ gjithashtu do të marrë parasysh zhvillimet e mëtejshme të rëndësishëm në praktikën gjyqësore të GjEDNj që nga hartimi i Rekomandimit Rec (2003)17 mbi përmbartimin.

4. CEPEJ, statuti i të cilit përfshin objektivin e lehtësimit të zbatimit të instrumenteve juridike ndërkombëtare të Këshillit të Evropës në lidhje me efikasitetin dhe paanësinë e drejtësisë, përfshin përmbarimin e vendimeve gjyqësore në listën e prioriteteve të saj. Si një hap i parë, CEPEJ ka autorizuar një studim të thellë në lidhje me çështjet e përmbarimit në shtetet anëtare, në mënyrë për të fituar një kuptim më të mirë se si ky funksionon dhe për të lehtësuar zbatimin në praktikë të standardeve përkatëse dhe instrumenteve të Këshillit të Evropës. Studimi, i kryer nga studiues ligjorë të Universitetit të Nancy (Francë) dhe Institutit Zvicërisht të Drejtës Krahësuese (Lausanne), propozoi një sërë udhëzimesh për qëllim të lehtësojë zbatimin e parimeve që përmbahen në rekomandimet e Këshillit të Evropës.

5. Si hap i dytë, CEPEJ ka krijuar një grup punues për përmbarimin e vendimeve gjyqësore (CEPEJ GT-exe), i ngarkuar me përpunimin e udhëzimeve për zbatimin efektiv të standardeve ekzistuese të Këshillit të Evropës. Në bazë të propozimeve të bëra në Studim, çdo anëtar i grupit punues ka hartuar një letër ku ka adresuar një grup të caktuar të çështjeve që lidhen me Udhëzimet në të ardhmen. CEPEJ pastaj ka mandatuar një ekspert shkencor, M. Julien LHUILLIER (Francë), për të përgatitur një sintezë të letrave të elaboruara.

### **Parimet dhe Objektivat e Përmbarimit**

6. Për të mbajtur sundimin e ligjit dhe që përdoruesit e gjykatës të kenë besim në sistemin gjyqësor, duhet të ketë procese efektive por të drejta të përmbarimit. Megjithatë, përmbarimi mund të arrihet vetëm kur i padituri ka mjetet apo kapacitetin për të përmbushur aktgjykimin.

7. Përmbarimi duhet të arrijë një ekuilibër mes nevojave të paditësit dhe të drejtave të paditurit. Shtetet anëtare inkurajohen për të monitoruar procedurat e përmbarimit, të kontrollojnë menaxhimin e gjykatave dhe të ndërmarrin veprimet e duhura për të siguruar barazi procedurale të palëve.

8. Procesi i përmbarimit duhet të jetë mjaftueshëm fleksibil në mënyrë që t'ia lejojë agjentit të përmbarimit një masë të arsyeshme të lirisë për të bërë marrëveshje me të paditurin, ku ka një konsensus midis paditësit dhe të paditurit. Marrëveshje të tilla duhet t'i nënshtrohen kontrollit të plotë për të siguruar paanësinë e agjentit të përmbarimit dhe mbrojtjen e interesave të kërkuarit si dhe palëve të treta.

Roli i agjentit të përmbarimit duhet të jetë i përcaktuar qartë në ligj kombëtar (për shembull shkalla e autonomisë së tyre). Ata mundën (për shembull), të kenë rolin e një "post ndërmjetësuesi gjyqësor", gjatë fazës së përmbarimit.

### **Proceset në gjykata**

9. Shtetet anëtare duhet të marrin masa për të siguruar që informacioni është në dispozicion në procesin e përmbarimit dhe se ka transparencë të aktiviteteve të gjykatës dhe të agjentit të përmbarimit në të gjitha fazat e procesit, me kusht që të drejtat e palëve janë të mbrojtura.

10. Pavarësisht nga roli i gjykatës në procesin e përmbarimit, duhet të ketë komunikim efektiv në mes të gjykatës, agjentit të përmbarimit, paraqitësit të kërkesës, dhe të paditurit. Të gjitha palët e interesuara duhet të kenë qasje në informata për procedurat e vazhdueshme dhe përparimin e tyre.

11. Shtetet anëtare duhet të ofrojnë palëve të mundshme në procedurat e përmbarimit informacion mbi efikasitetin e shërbimeve dhe procedurave të përmbarimit, duke krijuar treguesit e performancës të objektivave të caktuara dhe duke treguar kohën që procedurat e ndryshme mund të marrin.

12. Çdo autoritet duhet të sigurojë mbikëqyrjen adekuate (duke pasur parasysh në çdo rast vendimin përkatës të GJEDNJ) të procesit të përmbarimit dhe duhet të mbajnë përgjegjësi për efektivitetin e shërbimit. Llogaridhënia mund të arrihet nga raportet e menaxhimit dhe / apo reagimet e konsumatorëve. Cilido raport duhet të lejojë për vërtetimin që vendimi është përmbaruar, ose (në qoftë se jo) se janë ndërmarrë përpjekje të vërteta brenda një kohe të arsyeshme duke respektuar barazinë e palëve.

## **I. PËRGATITJA E PËRMBARIMIT**

### **1. Qasja në shërbimet e përmbarimit**

#### **1.1. Shpërndarja e shërbimeve të përmbarimit**

13. Shpërndarja gjeografike e agjentëve të përmbarimit brenda një vendi duhet të sigurojë mbulimin më të gjerë të mundshëm për të gjitha palët potenciale. Brenda një shteti anëtar të vetëm, kur autoritetet e ndryshme janë të ngarkuar me marrjen e masave në fusha të ndryshme të përmbarimit (p.sh. gjykatësi përgjegjës për përmbarimin dhe zyrtarët e thesarit), është e rëndësishme që t'i kushtohet vëmendje shpërndarjes si gjeografike dhe nga lloji i rastit, të gjitha autoriteteve përkatëse. Çdo pjesë e juridiksionit duhet të ketë mbulim të mjaftueshëm për secilin lloj të aktivitetit të përmbarimit.

14. Ku agjentët e përmbarimit ushtrojnë profesionin e tyre si një praktikë private, shtetet anëtare duhet të sigurojnë se ka konkurrencë të mjaftueshme dhe kompetenca gjeografike të përcaktuara qartë.

#### **1.2. Gjuha e përdorur**

15. Duhet të merren masa për të siguruar që palët janë në gjendje të kuptojnë procesin e përmbarimit, në të cilin ata janë të përfshirë, dhe, kur është e mundur, të kenë mundësi të marrin pjesë në procedurë, pa nevojë për përfaqësim ligjor. Për këtë qëllim, proceset e përmbarimit dhe legjislacioni duhet të jenë sa më të qarta dhe të kuptueshme të jetë e mundur (p.sh. duke krijuar versione të thjeshta gjuhësore të legjislacionit, doracakë të përmbarimit, duke zvogëluar kohën e kontaktit që palët duhet të kenë me gjykatën si fizikisht ashtu dhe në korrespondencë, etj).

#### **1.3. Disponueshmëria e akterëve të përfshirë në procedurën e përmbarimit**

16. Të gjithë hisedarët që mund të përfshihen në proceset e përmbarimit (policia, ekspertët, përkthyesit, autoritetet lokale, siguresit e rrezikut, ekspertë të kujdesit të fëmijës, etj) duhet të kenë status të mjaftueshëm ligjor për të ndihmuar agjentin e përmbarimit dhe duhet të jenë menjëherë në dispozicion, në rast se ndihma e tyre është e nevojshme për përmbarimin e një

vendimi. Punëtorët social duhet të jenë veçanërisht në dispozicion në rastet kur fëmijët dhe personat e tjerë të rrezikuar janë të shqetësuar nga procedura e përmbarrimit.

## **2. Njoftimet e palëve dhe palëve të treta**

17. Njoftimet për palët në lidhje me përmbarrimin e vendimeve gjyqësore ose të dokumenteve përmbarruese, të noterizuara ose dokumenteve tjera janë një aspekt thelbësor i ligjit të përmbarrimit. Njoftimi me kohë i palëve është një element i domosdoshëm i një gjykimi të drejtë, në kuptim të nenit 6.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

18. Shtetet anëtare mund të hartojnë dokumente standarde për njoftimin e palëve. Këto dokumente standarde mund të lidhen me fazat e ndryshme në procesin e përmbarrimit dhe për çdo mjet juridik i cili lejon ankimin ndaj përmbarrimit. Ata mund të kenë këto qëllime:

- për të njoftuar të paditurin mbi pasojat e përmbarrimit (duke përfshirë koston e përmbarrimit) dhe të shpenzimeve të një dështimi të respektimit të vendimit i cili urdhëron ata të paguajë;
- për të njoftuar të paditurin mbi masat e përmbarrimit që do të merren ndaj tyre, pasi ato janë zbatuar, në mënyrë që t'i mundësojë të paditurit të respektojë ose, kur është e zbatueshme, të ankimohet në çdo masë;
- mbajtjen e paraqitësve të kërkesave plotësisht të informuar për fazat e arritura të procedurës së përmbarrimit;
- njoftimin e palëve të treta për të siguruar, së pari, se të drejtat e tyre respektohen dhe, së dyti, se ata janë në gjendje për të përmbushur cilindo detyrim mbi ta dhe të jenë të vetëdijshëm për pasojat e një dështimi për të përmbushur vendimin.

19. Njoftimet në të gjitha rastet duhet të nxisin të paditurin që të respektojë urdhrin e gjykatës vullnetarisht dhe të përfshijnë një paralajmërim që në rast të jo-pajtueshmërisë mund të përdoren masa përmbarruese, duke përfshirë, nëse është e nevojshme, shpenzime të mëtejshme që mund të aplikohen.

20. Duhet të jetë e mundur që përmbarruesve tu besohet dorëzimi i njoftimeve. Për këtë qëllim, shtetet anëtare duhet të përcaktojnë kushtet për një metodë të sigurt për dorëzimin e dokumenteve.

21. Ku njoftimet gjenerojnë të drejta ose detyrime, është detyrë e përmbarruesit për të siguruar që palëve u është dorëzuar njoftimi adekuat në kohën e duhur.

22. Ku pasuritë e të paditurit duhet të shiten në një ankand publik pas sekuestrimit të tyre, blerësit potencial duhet të njoftohen paraprakisht me mjete efikase komunikimi, duke garantuar shpërndarjen e shpejtë të informacionit për publikun më të gjerë të mundshëm, ndërkohë që sigurohet privatësia e të paditurit. Shtetet anëtare duhet të propozojnë standardet minimale të shpërndarjes duke marrë parasysh natyrën e pasurive, vlerën e tyre të përafërt dhe datën e shitjes.

### **3. Titulli i përmbareueshëm: Përkufizimi dhe forma e titullit**

23. Korniza legjislative kombëtare duhet të përmbajë një përcaktim të qartë të asaj që konsiderohet titulli i përmbareueshëm dhe kushtet e përmbareueshmërisë së tij.

24. Titujt e përmbareimit duhet të hartohen në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke mos lënë asnjë mundësi për keqinterpretim.

### **4. Agjentët e përmbareimit**

#### **4.1. Kushtet për kualifikim**

25. Për administrimin e drejtë të drejtësisë, është e rëndësishme që cilësia e përmbareimit të jetë e garantuar. Shtetet anëtare duhet të kryejnë akreditimin e agjentëve të përmbareimit vetëm në qoftë se kandidatët në fjalë janë të një standardi dhe të trajnuar në përputhje me ndërlikueshmërinë e detyrave të tyre. Një cilësi e lartë e trajnimit të profesionistëve është e rëndësishme për shërbim të drejtësisë dhe për të rritur besimin e përdoruesve të sistemit të drejtësisë.

26. Nga agjentët e përmbareimit duhet gjithashtu të kërkohet për të ndjekur trajnimin e detyrueshëm të vazhdueshëm.

27. Rekomandohet që të krijohen lidhje në mes të institucioneve kombëtare të trajnimit. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që agjentët e përmbareimit të përfshihen në programe të përshtatshme trajnimi dhe duhet vendosur standardet e përbashkëta minimale për instruktorët në vendet e ndryshme anëtare.

28. Trajnimi fillestar dhe i vazhdueshëm mund të përfshijë:

- parimet dhe objektivat e përmbareimit;
- sjellja profesionale dhe etike;
- fazat në procesin e përmbareimit;
- organizimin, përshtatshmërinë dhe zbatimin e masave të përmbareimit;
- kornizën ligjore;
- simulimet dhe ushtrimet praktike të përshtatshme;
- vlerësimin e njohurive të trajnuarve;
- përmbareimin ndërkombëtar të vendimeve gjyqësore dhe titujve të tjerë të përmbareimit.

#### **4.2. Organizimi i profesionit dhe statusi i agjentit të përmbareimit**

29. Me qëllim të administrimit të mirë të drejtësisë, është e nevojshme që agjentët e përmbareimit duhet të organizohen në një trup profesional që përfaqëson të gjithë anëtarët e profesionit, duke lehtësuar përfaqësimin e tyre kolektiv dhe grumbullimin e informacionit.

30. Në vendet anëtare të cilat kanë themeluar organizata profesionale të përmbareuesve, anëtarësimi në këtë organ përfaqësues duhet të jetë i detyrueshëm.

31. Statusi i agjentëve të përmbarrimit duhet të përcaktohet qartë në mënyrë që palëve të mundshme për procedurat e përmbarrimit t'i ofrohet një profesionist që është i paanshëm, i kualifikuar, i përgjegjshëm, në dispozicion, i motivuar dhe efikas.

32. Ku agjentët e përmbarrimit janë punonjës të shtetit, ata duhet të gëzojnë kushte të përshtatshme të punës dhe burime të mjaftueshme njerëzore dhe materiale. Për shembull, duke i bërë të mundur personelit për të punuar me qasje në komunikimin modern dhe pajisje të IT (kompjuterë, telefona, fakse, lidhjet e internetit, sistemet e IT të azhurnuara) dhe me mjetet e përshtatshme të transportit, të mjaftueshme për të lejuar ata që të kryejnë rolin e tyre në mënyrën më efektive që të jetë e mundur.

#### **4.3. Të drejtat dhe detyrimet**

33. Agjentët e përmbarrimit, siç përcaktohet me ligj të një vendi, duhet të jenë përgjegjës për zhvillimin e përmbarrimit brenda kompetencave të tyre të përcaktuara nga legjislacioni kombëtar. Shtetet anëtare duhet të konsiderojnë që agjentëve të përmbarrimit t'i jepet kompetencë e vetme për:

- përmbarrimin e vendimeve gjyqësore dhe titujve ose dokumenteve të tjera të përmbarrueshme dhe
- zbatimin e të gjitha procedurave të përmbarrimit të parashikuara nga ligji i shtetit në të cilin ata veprojnë.

34. Agjentët e përmbarrimit mund të jenë të autorizuar për të kryer aktivitetet dytësore në përputhje me rolin e tyre, duke u kujdesur për të mbrojtur dhe siguruar njohjen e të drejtave të palëve dhe që synojnë përshpejtimin e procesit gjyqësor ose reduktimin e ngarkesës së punës së gjykatave. Këto mund të jenë, ndër të tjera:

- kthimi i borxhit;
- shitja vullnetare pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme në ankand publik;
- konfiskim i mallrave;
- regjistrimi dhe raportimi i të dhënave;
- shërbimi si korrier të gjykatave;
- ofrimi i këshillave ligjore;
- procedurat e falimentimit;
- kryerja e detyrave të caktuara për ta nga gjykatat;
- përfaqësimi i palëve në gjykata;
- hartimi i dokumenteve;
- mësimdhënia.

35. Agjentët e përmbarrimit duhet të detyrohen të kryejnë rolin e tyre kur ata janë të detyruar ligjërisht ta bëjnë këtë, përveç në rastet kur ka pengesa ose kur ata janë në lidhje gjaku ose martesore me një palë. Agjentët e përmbarrimit duhet të jenë të përjashtuar nga obligimi për të vendosur për të drejtat dhe veprimet e konstestueshme në rastet me të cilat ata merren.

36. Ku agjentët e përmbarrimit janë profesionistë të pavarur, ata duhet të jenë të detyruar për të hapur një llogari jo-personale të destinuar posaçërisht për depozitimin e mjeteve të grumbulluara në emër të klientëve. Kjo llogari duhet t'i nënshtrohet inspektimit. Nga ata po

ashtu duhet të kërkohet të jenë të siguruar nga detyrimet profesionale dhe përgjegjësi civile. Agjentët e përmbarimit duhet të përfitojnë nga mbrojtja e sigurimeve shoqërore.

#### **4.4. Shpërblimi**

37. Ku agjentët e përmbarimit janë punonjës të shtetit, shteti duhet të sigurojnë që ata të marrin shpërblim përkatës, veçanërisht duke pasur parasysh nivelin e tyre të trajnimit, përvojën dhe vështirësitë e hasura në detyrën e tyre.

#### **4.5. Etika dhe sjellja profesionale**

38. Agjentët e përmbarimit duhet t'i nënshtrohen rregullave të qarta të etikës dhe të sjelljes, të cilat mund të jenë të përcaktuara në kodet profesionale të sjelljes. Këto Kode të mirësjelljes duhet të përmbajnë, ndër të tjera, standardet profesionale lidhur me:

- informatat që duhet dhënë palëve nga agjentët e përmbarimit në lidhje me procedurën e përmbarimit (baza e veprimit, transparenca dhe qartësia e shpenzimeve, etj)
- rregullat mbi formulimin e njoftimeve të palëve (rolin shoqëror të agjentëve të përmbarimit, detyra këshillëdhënëse, etj)
- etikën profesionale (sjellja, fshehtësia profesionale, kriteret etike që përcaktojnë zgjedhjen e veprimeve, etj)
- përmbarimin e qetë (parashikueshmëria dhe proporcionaliteti i shpenzimeve dhe kohës, bashkëpunimi në mes të shërbimeve të përmbarimit, etj)
- fleksibiliteti procedural (autonomia e agjentëve të përmbarimit, etj).

## **II. REALIZIMI I PËRMBARIMIT**

### **1. Informacioni në lidhje me të paditurin dhe pasuritë**

#### **1.1 Informacioni në dispozicion të paditësit**

39. Në mënyrë që të sigurohet e drejta e paraqitësit të kërkesës për ndihmë të mjaftueshme për procedurat e përmbarimit, këtyre të fundit duhet t'i lejohet qasja në regjistrat publike, në mënyrë që ata të mund të konfirmojë informacionet thelbësore në lidhje me të paditurin, të tilla si informacioni për të identifikuar të paditurin dhe vendndodhjen e tij për qëllime të përmbarimit dhe të dhënat që merren nëpërmjet regjistrave publik (dmth. regjistrat e tokës, regjistrat gjyqësore të kompanive, etj), që i nënshtrohen ligjeve kombëtare mbi lirinë e qasjes në informata dhe të mbrojtjes së të dhënave.

Të dhënat e mësipërme duhet të jenë në dispozicion të paditësit me një kërkesë me shkrim që jep dëshmi të mjaftueshme të ekzistimit të interesit (dmth aktgjykimi ose në një tjetër titull i përmbarueshëm).

#### **1.2. Qasja e agjentëve të përmbarimit në informata**

40. Në mënyrë që agjentët e përmbarimit të mund të nxjerrin një vlerësim të kostove dhe të sigurojnë që masat e ndërmarra janë në përpjesëtim me ato shpenzime, shtetet anëtare duhet tu lejojnë atyre qasje të shpejtë dhe mundësisht të drejtpërdrejtë në informacion mbi pasuritë

e të paditurit. Shtetet anëtare janë të inkurajuara të konsiderojnë sigurimin e qasjes në këtë informacion agjentit të përmbarimit përmes një qasje të sigurt interneti, nëse është e mundur.

41. Me qëllim të parandalimit që të paditurit t'i shmangen përmbarimit duke zhvendosur pasuritë e tyre, shtetet anëtare janë të inkurajuara që të krijojnë një bazë të dhënave shumë-burimore me qasje të kufizuar, në lidhje me pasuritë e debitorit (p.sh. të drejtat e pronësisë mbi një automjet, të drejtat e pasurive të patundshme, borxhet e pagueshme, kthimet e tatimit, etj.) Shtetet anëtare duhet të sigurojnë bazën e të dhënave me një nivel të pranueshëm të sigurisë, në lidhje me rreziqet e shkaktuara. Qasja e agjentit të përmbarimit në bazën e të dhënave duhet të kufizohet në të dhënat që kanë të bëjnë me procedurat në pritje të përmbarimit dhe do të duhet t'i nënshtrohet kontrollit të plotë. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë të paditurve mjete efektive ligjore për të siguruar se çdo hetim në lidhje me pasuritë e tyre personale është i justifikuar.

42. Bashkëpunimi midis organeve të ndryshme të institucioneve shtetërore dhe private, në pajtueshmëri me legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave, është thelbësor për të mundësuar një qasje të shpejtë në informacione shumë-burimore të pasurisë së të paditurit. Duhet të hartohen protokolle dhe procedura uniforme për të garantuar bashkëpunimin midis departamenteve, në njërën anë, dhe bashkëpunimin në mes këtyre departamenteve dhe shërbimeve të përmbarimit, nga ana tjetër.

### **1.3. Obligimi për sigurim të informacionit**

43. Të gjitha organet shtetërore, të cilat administrojnë bazat e të dhënave me informatat e kërkuara për përmbarimin efikas, duhet të kenë një obligim të sigurojnë informata për agjentin e përmbarimit, brenda një afati të përcaktuar, në qoftë se informacioni i tillë është në përputhje me legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave.

### **1.4. Mbrojtja e të dhënave**

44. Rekomandohet që legjislacioni kombëtar mbi mbrojtjen e të dhënave personale duhet të shqyrtohet në rast se duhet të përshtatet për të lejuar procedurat e përmbarimit efikas.

45. Agjentët e përmbarimit duhet të mbajnë përgjegjësi për ruajtjen e fshehtësisë, kur informacioni sekret, i fshehtë ose i ndjeshëm paraqitet në rrjedhën e procedurave të përmbarimit. Në rast të shkeljes së kësaj detyre, masa e përgjegjësisë disiplinore duhet të jetë e zbatueshme, së bashku me sanksionet civile dhe penale.

### **1.5. Përdorimi i shumëfishtë i informacionit**

46. Shtetet anëtare janë të ftuara të marrin në konsideratë që të lejojnë agjentët e përmbarimit për ripërdorimin informacionit mbi pasuritë e të paditurit në procedurat e mëvonshme që përfshijnë të paditurit e njëjtë. Ripërdorimi i informacionit duhet megjithatë t'i nënshtrohet një kornize të qartë dhe të saktë ligjore (pra vendosja e afateve të rrepta për mbajtjen e të dhënave, etj).



## **2. Shpenzimet e përmbarrimit**

### **2.1. Rregullimi i shpenzimeve**

47. Çdo shtet anëtar është i inkurajuar për të aprovuar rregulla që rregullojnë nivelin e shpenzimeve të përmbarrimit për të siguruar qasjen efektive në drejtësi sidomos nëpërmjet ndihmës ligjore apo skemave për heqjen e shpenzimeve apo një shtyrje të pagesës së tyre, kur shpenzimet e tilla ka të ngjarë të bien mbi palët. Palët duhet të jenë të mbrojtura për të siguruar se ato do të paguajnë vetëm shpenzimet e përcaktuara me ligj.

48. Ku, brenda shtetit anëtar të njëjtë, ka agjentë të përmbarrimit që punojnë edhe në sektorin privat dhe atë publik, shteti duhet të shmang çdo diskriminim në lidhje me shpenzimet e debitorit në mes të agjentëve të përmbarrimit të statusit të ndryshëm por me kompetencë të barabartë.

49. Shtetet anëtare duhet të prezantojnë një procedurë me të cilën palët mund të kundërshtojnë shpenzimet e përmbarruesve.

### **2.2. Transparenca e shpenzimeve të përmbarrimit**

50. Ku shpenzimet e përmbarrimit kanë gjasa të bien mbi palët, shtetet anëtare duhet të sigurojnë që këto të fundit janë të informuara sa më plotësisht të jetë e mundur në lidhje me shpenzimet e përmbarrimit (tarifat e përmbarrimit dhe pagesat e performancës përkatëse me rastin e përfundimit me sukses). Ky informacion duhet të jetë në dispozicion për palët, jo vetëm nga agjenti i përmbarrimit, por edhe nga gjykatat, organizatat e konsumatorëve, kodet procedurale ose nëpërmjet faqeve zyrtare të internetit të autoriteteve gjyqësore dhe profesionale.

51. Duke njohur lëvizjen në rritje të personave dhe të shërbimeve në Evropë, ka një nevojë në rritje për përmbarrimin e vendimeve gjyqësore ndërkombëtare. Transparenca e shpenzimeve të përmbarrimit duhet të shkojë përtej nivelit të brendshëm: shtetet anëtare duhet të bien dakord për të ngritur një bazë të dhënave të shumave të tarifuara për veprimet më të shpeshta të kryera procedurale dhe të vendosin atë në dispozicion sa më të gjerë që është e mundur, me qëllim për tu dhënë personave në shtetet e tjera anëtare qasjen në strukturën tarifave të secilit vend.

### **2.3. Qartësia dhe parashikueshmëria e tarifave të përmbarrimit**

52. Tarifat e përmbarrimit duhet të jenë publike. Shtetet anëtare janë të inkurajuar që të kërkojnë që çdo dokument procedural të tregojë qartë sasinë e veprimit dhe të parashikojnë sanksione në rast të mos-pajtueshmërisë (dmth. pavlefshmërinë e dokumenteve të dështuar në përputhje me kërkesat etj).

53. Ku situata financiare e të paditurit është e njohur për agjentin e përmbarrimit dhe ai rekomandon një proces të veçantë të përmbarrimit, ai duhet të informojë paditësin në lidhje me llojin e veprimit të parashikuar dhe shpenzimet e mundshme që rezultojnë, në fillim dhe në çdo fazë të procedurës.

54. Qartësia e tarifave është një faktor në transparencën e shpenzimeve të përmbarrimit. Në mënyrë që të jetë sa më shumë e kuptueshme, pagesa për një veprim duhet të varet nga një numër i kufizuar i faktorëve. Tarifa duhet të përcaktohet në rregullore sa më thjeshtë, qartë dhe koncize që është e mundur.

55. Kur caktohen tarifat e përmbarrimit, shtetet anëtare duhet të shkëmbejnë përvojat e tyre dhe të marrin në konsideratë disa faktorë, të tillë si sasia e borxhit, çdo urgjencë të veçantë dhe vështirësi me të cilat përmbarruesi mund të ballafaqohet.

#### **2.4. Rëndësia e ndërmarrjes së veprimeve**

56. Kostoja përfundimtare e përmbarrimit duhet të jetë në proporcion me mjetet e kërkuara. Shtetet duhet të përpiqen të sigurojnë një procedurë efektive të përmbarrimit për të gjitha nivelet e borxheve, të mëdha apo të vogla.

57. Është përgjegjësi e agjentit të përmbarrimit të ndërmerr të gjitha hapat e arsyeshëm dhe të nevojshëm në përmbarrim dhe të vendosë cilat veprime të përmbarrimit janë më të përshtatshme. Ku shpenzimet janë konsideruar të parëndësishme apo janë bërë gabimisht, këto shpenzime duhet të mbulohen nga përmbarruesit.

58. Shtetet anëtare që sigurojnë ndihmë juridike duhet të vërtetojnë lidhjen e shpenzimeve të bëra, në mënyrë që komuniteti nuk duhet të bartë shpenzimet e pajustificuara.

59. Ku një agjent i përmbarrimit ka një detyrë për të ofruar këshilla të duhura, ai / ajo duhet të shpjegojë në mënyrë të qartë situatën e kërkesave dhe rëndësinë e veprimit që sugjerojnë të ndërmerret.

#### **2.5. Alokimi i shpenzimeve të përmbarrimit**

60. Tarifat e përmbarrimit duhet të mbulohen nga të paditurit, ku ai ose ajo është likuid, së bashku me mundësinë e një tarife të performancës që mbulohet nga paditësi. Ku i padituri është i paaftë për të paguar, tarifat e përmbarrimit duhet të paguhen nga paditësi.

61. Ku përmbarrimi konsiderohet të jetë i gabuar ose i parregullt, përgjegjësi për shpenzimet duhet të mbahet nga personat ose njësitë përgjegjëse për aktin e gabuar ose të parregullt.

#### **2.6. Ndihma juridike**

62. Për të garantuar qasje në drejtësi, skemat e ndihmës juridike, apo skemat alternative të financimit, duhet të jenë në dispozicion të paditësve të cilët nuk janë në gjendje të paguajnë tarifat e përmbarrimit (p.sh. me anë të financimit nga shteti ose nga kthimi i tarifave). Ku ndihma juridike është siguruar, shteti mund, nëse konsiderohet e drejtë, të pajis veten me mekanizmat që lejojnë kthimin e shpenzimeve të tij nga të ardhurat e përmbarrimit.

### **3. Afatet kohore dhe raportet**

#### **3.1. Afatet kohore për procedurat e përmbarimit**

##### **3.3.1. Afatet e arsyeshme dhe të parashikueshme**

63. Afatet kohore për procedurat e përmbarimit duhet të jenë të arsyeshme dhe shtetet anëtare nuk duhet të imponojnë ndonjë afat arbitrar për përfundimin e përmbarimit.

64. Shtetet anëtare duhet të caktojnë kritere të përcaktuara qartë dhe saktë në lidhje me natyrën e arsyeshme të kohëzgjatjes, e cila mund të ndryshojnë në varësi nga natyra e rastit dhe lloji i veprimit të kërkuar.

65. Duke pasur parasysh rëndësinë e të qenit në gjendje të parashikohet kohëzgjatja e procedurave të përmbarimit nga pikëpamja e sigurisë ligjore, shtetet anëtare duhet të konsiderojnë krijimin e bazave të dhënave publike statistikore, duke bërë të mundur palëve për të llogaritur kohëzgjatjen e mundshme të përmbarimit të masave të ndryshme të mundshme në legjislacionin e brendshëm (p.sh., shtojca e pagës, lidhja e aktiveve të bankës, dhe shtojca e automjetit). Bazat e të dhënave duhet të hartohen në bashkëpunim me profesionistë të ligjit mbi përmbarimin dhe duhet të vihen në dispozicion sa më gjerësisht të jetë e mundur, me qëllim të dhënies personave në shtetet e tjera anëtare qasje në strukturën e secilit vend në lidhje me kohëzgjatjen, ashtu që mund të bëhen krahasime.

##### **3.3.2. Faktorët e përmbarimit të qetë dhe të shpejtë**

66. Në fazën e përmbarimit të vendimeve, duhet të jetë i mundur komunikimi i shpejtë (të tilla si e-mail), me gjykatën, agjentët e përmbarimit dhe palët.

67. Shtetet anëtare mund të sigurojnë që korniza ligjore e përmbarimit nuk është pa nevojë e zgjatur. Shtetet anëtare janë të inkurajuar, në mënyrë të veçantë, për të marrë masa për të lehtësuar kornizën procedurale të përmbarimit, për t'i dhënë agjentëve të përmbarimit autonominë e nevojshme për të zgjedhur për veten e tyre, pa autorizim paraprak, hapat procedurale që janë më të përshtatshme për rastin në fjalë.

68. Shtetet anëtare duhet gjithashtu të sigurojnë që i padituri mund të marrë masa për të sfiduar masat e përmbarimit, brenda një afati të arsyeshëm kohor, me kusht që kjo nuk do të ndalë në mënyrë të pajustificuar apo shkakton vonesa të procedurave të përmbarimit; për shembull kur një i paditur dëshiron të ankohet kundër një vendimi, duhet të ekzistojë një makineri që të lejojë atë që të ofrojë siguri për mbrojtjen e paditësit.

69. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë një procedurë të përsheptuar dhe urgjente të përmbarimit në rastet kur një vonesë mund të rezultojë në një dëmtim të pakthyeshëm (dmth. rastet e gjykatës familjare brenda provincës, raste të arratisjes të paditurit, dëbimit, dëmtimit të pasurive, etj).

70. Prioritet duhet gjithmonë t'i jepet arritjes së marrëveshjes midis palëve në mënyrë që të koordinohen afatet kohore të përmbarimit. Ku palët pajtohen ndërmjet tyre për një afat kohor

për përmbarrimin, çdo procedurë e mëtejme e vënë në vend nga ana e shtetit anëtar nuk duhet të pengojë që këto marrëveshje të hyjnë në fuqi.

71. Pretendimet e të paditurit kundër një agjent të përmbarrimit, për sjellje të keqe, nuk duhet të pengojnë ose vonojnë procesin e përmbarrimit, përveç kur ka ndërhyrje gjyqësore. Ankesat kundër përmbarruesit duhet të hetohen njëkohësisht me procedurat e ekzekutimit.

### **3.4. Raportimi mbi procedurën e përmbarrimit**

#### **3.4.1. Raportimi për çdo masë të përmbarrimit**

72. I padituri duhet të informohet deri në masën e detyrimit të tij gjatë procesit të përmbarrimit.

#### **3.4.2. Raportimi mbi procedurë e përfunduar të përmbarrimit**

73. Pasi që interesat e paraqitësit të kërkesës janë plotësuar, ky informacion duhet t'i komunikohet kërkuarit. Shtetet anëtare janë të inkurajuar që të vendosin rregulla të qarta që rregullojnë obligimin për të raportuar për procedurat në pritje dhe / ose të përfunduara të përmbarrimit (p.sh. nëpërmjet një regjistri publik, ku regjistrohen rezultatet e veprimeve individuale të përmbarrimit kundër të paditurve).

#### **3.4.3. Standardet evropiane mbi informimin**

74. Shtetet anëtare fuqimisht inkurajohen të nxjerrin standarde të përbashkëta evropiane të cilësisë në lidhje me informacionin që duhet të sigurohet për palët dhe për publikun e gjerë në lidhje me procedurat e përmbarrimit.

## **III. Mbikëqyrja, kontrolli dhe procedurat disiplinore**

### **1. Kontrolli i cilësisë së procesit të përmbarrimit**

75. Në mënyrë që të marrin përsipër kontrollin e cilësisë së procedurave të përmbarrimit, çdo Shtet Anëtar duhet të vendosë standardet/kriteret evropiane të cilësisë, me qëllim të vlerësimit vjetor, përmes një sistemi të pavarur të inspektimit të rastit dhe të efikasitetit të shërbimeve të përmbarrimit. Në mesin e këtyre standardeve, duhet të ketë:

a) një kornizë të qartë ligjore të procedurave të përmbarrimit për themelimin e autorizimeve, të drejtave dhe përgjegjësisë të palëve dhe palëve të treta;

b) shpejtësi, efikasitet dhe shpenzime të arsyeshme të procedurës;

c) respektimi i të gjitha të drejtave të njeriut (dinjiteti njerëzor, duke mos i hequr të paditurit një standard minimal të jetesës së thjeshtë ekonomike dhe duke mos ndërhyrë në mënyrë jo proporcionale me të drejtat e palëve të treta, etj)

d) përputhja me një procedurë dhe metoda të përcaktuara (dmth disponueshmëria e mjeteve ligjore që do të paraqiten në gjykatë brenda kuptimit të nenit 6 të KEDNj-së);

e) proceset të cilat duhet të dokumentohen;

f) forma dhe përmbajtja e dokumenteve që duhet të jenë të standardizuar;

g) mbledhja e të dhënave dhe ngritja e një sistemi statistikor kombëtar, duke marrë në konsideratë, nëse është e mundur, Skemën e Vlerësimit të CEPEJ dhe të dhënat e rëndësishme të drejtësisë të përcaktuara nga CEPEJ;

h) kompetencat e agjentëve të përmbarimit;

i) performancën e agjentëve të përmbarimit;

j) procedura në bazë vjetore:

- numri i lëndëve të pazgjidhura,
- numri i lëndëve të pranuar,
- numri i lëndëve të përmbaruara,
- shkalla e kryerjes,
- koha e përfundimit të përmbarimit,
- normat e suksesit (rikuperimi i borxheve, dëbime të suksesshme, mbledhja e shumave të papaguara, etj)
- shërbimet e kryera gjatë përmbarimit (përpjekjet për zbatim, koha e harxhuar, dekretet, etj)
- shpenzimet e bëra dhe si ato janë të mbuluara
- numri i ankesave dhe mjeteve juridike në lidhje me numrin e rasteve të zgjidhura.

76. Të dhënat e performancës duhet të bazohen në mostra përfaqësuese dhe duhet të botohen.

77. Këto kritere të vlerësimit mund të përcaktohen në një nivel evropian, në mënyrë që të forcojnë besimin në mes të shteteve anëtare, veçanërisht duke pasur parasysh perspektivën e një numri në rritje të rasteve ndërkombëtare të përmbarimit.

## **2. Mbikëqyrja dhe kontrolli i aktiviteteve të përmbarimit**

78. Autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe / ose kontrollin e agjentëve të përmbarimit kanë një rol të rëndësishëm në garantimin e cilësisë të shërbimeve të përmbarimit. Vendet anëtare duhet të sigurojnë që aktivitetet e tyre të përmbarimit të vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme. Ky vlerësim duhet të kryhet nga një organ jashtë autoriteteve të përmbarimit (për shembull, nga një organ profesional). Autoritetet e vendeve anëtare duhet të përcaktojnë qartë procedurat e kontrollit që do të kryhen gjatë inspektimeve.

79. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që monitorimi i aktiviteteve të përmbaruesve nuk e pengon mbarëvajtjen e punës së tyre.

### **3. Procedurat disiplinore dhe sanksionet**

80. Shkeljet e ligjeve, rregulloreve ose rregullave të etikës të kryera nga agjentët e përmbartimit, madje edhe jashtë fushëveprimit të aktiviteteve të tyre profesionale, duhet t'i nënshtroj ata ndaj sanksioneve disiplinore, pa rënë ndesh me sanksionet eventuale civile dhe penale.

81. Procedurat disiplinore duhet të kryhen nga një autoritet i pavarur. Shtetet anëtare duhet të konsiderojnë futjen e një sistemi për filtrimin paraprak të rasteve të cilat janë paraqitur si taktika të vonesës.

82. Duhet të hartohet një listë e qartë e sanksioneve, që përcakton një shkallë të masave disiplinore në përputhje me seriozitetin e shkeljes. Përrjashtimi nga shërbimi apo "shlyerja nga regjistri ", duhet të bëhet vetëm për shkeljet më të rënda (duhet të respektohet parimi i proporcionalitetit në mes të shkeljes dhe sanksionit).

## FJALOR

Për qëllimet e këtyre Udhëzimeve, shprehjet e mëposhtme duhet të kuptohen si në vijim:

*Përmbarimi*: vënia në fuqi e vendimeve gjyqësore, dhe gjithashtu titujve të përmbarueshme tjera gjyqësore apo jo-gjyqësore në përputhje me ligjin që detyron të paditurin për të bërë, që të përmbahen nga bërja ose për të paguar atë që është vendosur (burimi: Rekomandimi Rec (2003) 17 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi përmbarimin).

*Paditësi*: Një palë që kërkon përmbarimin. Në çështjet civile, paditësi është zakonisht një kreditor, por të dy shprehjet nuk janë sinonime pasi që paditësi mund në mënyrë të barabartë të kërkojë edhe përmbarimin e një "detyrimi për të bërë", ose "të përmbahet nga të bërit".

*Qartësia e tarifave të përmbarimit*: Tarifat e përmbarimit duhet të jenë të përcaktuara thjesht, qartë dhe me saktësi. Qartësia e tarifave të përmbarimit është një tregues i transparencës së shpenzimeve të përmbarimit (q.v).

*Kontrolli i aktiviteteve*: Kontrolli i aktiviteteve do të thotë kontrolli i ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga agjentët e përmbarimit. Ajo mund të kryhet *a priori* (para se të veprojnë agjentë të përmbarimit), apo *a posteriori* (pasi vepron përmbaruesi) nga një autoritet "disiplinor" (Shih mbikëqyrjen e aktiviteteve).

*I padituri*: Një palë ndaj të cilës kërkohet përmbarimi (burimi: Rekomandimi Rec (2003) 17 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi përmbarimin). Në çështjet civile, i padituri është zakonisht një debitor, por të dy termat nuk janë sinonime (shih paditësi).

*Agjenti i përmbarimit (Përmbaruesi)*: Një person i autorizuar nga shteti për të kryer procesin e përmbarimit (burimi: Rekomandimi Rec (2003) 17 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi përmbarimin).

*Rast i përmbarueshëm*: Në mënyrë që të përmbarohet, rasti duhet të ketë qenë subjekt i një veprimi që ka kënaqur plotësisht paditësin (në një çështje civile).

*Shpenzimet e përmbarimit*: Shpenzimet e përmbarimit përbëhen nga shpenzimet e përmbarimit (= tarifat e përmbarimit) dhe çdo shpërblim të performancës (= tarifat e performancës) të paguara nga paditësi për agjentin e përmbarimit në formën e tarifave (Shih tarifat e përmbarimit dhe pagesat e performancës).

*Tarifat e përmbarimit*: shpenzimet e procesit në vetvete, me fjalë të tjera, totali i shumave për çdo veprim të ndërmarrë nga përmbaruesi në rrjedhën e një rasti të vetëm (shih shpenzimet e Përmbarimit).

*Shërbimet e Përmbarimit*: Të gjitha profesionet që kryejnë detyrën e përmbarimit.

*Afati kohor i përmbarimit*: Në teori, periudha e veprimit ose pritjes në mes të fillimit dhe përfundimit të procesit të përmbarimit. Në praktikë, kjo është shuma e periudhave të nevojshme për plotësimin e të gjitha veprimeve të kryera nga përmbaruesit.

*Fleksibiliteti i përmbartimit:* Natyra e një sistemi të përmbartimit që i mundëson përmbartuesit për të zgjedhur kornizën procedurale e cila është më e përshtatshme për tiparet e një rasti. Fleksibiliteti i përmbartimit është i lidhur ngushtë me autonominë e agjentit të përmbartimit (shih përmbartimi i qetë).

*Kufijtë e parashikueshëm kohor:* Në teori, koha brenda së cilës përdoruesi është informuar se procesi i përmbartimit duhet të përfundojë. Në praktikë, kjo kohë është shpesh e kufizuar me kohën e nevojshme për përfundimin e masës së ardhshme të përmbartimit.

*Tarifat e performancës:* shuma e pagueshme nga paditësi për agjentin e përmbartimit në rast të përmbartjes. Sipas legjisllacionit të vendeve të ndryshme, tarifat mund të negociohen, vendosen paraprakisht ose të ndalohen (Shih shpenzimet e përmbartimit).

*Parashikueshmëria e shpenzimeve të përmbartimit:* Në teori, shpenzimet për të cilat përdoruesi është informuar nga agjenti i përmbartimit, që zakonisht korrespondojnë me shpenzimet e tërë procesit të përmbartimit. Në praktikë, parashikueshmëria është shpesh e kufizuar në shpenzimet e nevojshme për përfundimin e masës së ardhshme të përmbartimit. Parashikueshmëria e shpenzimeve nuk duhet të ngatërrohet me transparencën (q.v).

*Cilësia (ose normat e standardit):* Kriteret sasiore ose cilësore që bëjnë të mundur të identifikojnë dhe / ose të mbikëqyrin përputhshmërinë me kërkesat minimale të përmbartimit të kënaqshëm.

*Rëndësia e marrjes së veprimit:* Rëndësia e marrjes së veprimit është vlerësimi i përshtatshmërisë për të filluar një proces të përmbartimit. Ajo është e vlerësuar ndryshe nga paditësi dhe përmbartuesi. Kjo është një tregues i parashikueshmërisë së shpenzimeve të përmbartimit (q.v).

*Grupet e interesit:* personat e përfshirë në mënyrë indirekte në procedurën e përmbartimit.

*Përmbartimi i qetë:* Zbatimi brenda një kohe të arsyeshme dhe pa pengesa administrative ose periudha të pajustificueshme të pasivitetit; ky koncept është i bazuar jo vetëm në shpejtësinë e kryerjes së veprimeve, por edhe në shpejtësinë në mes të veprimeve të ndryshme. Fleksibiliteti i veprimit (q.v) është prandaj një faktor në përmbartimin e qetë.

*Mbikëqyrja e aktiviteteve:* Mbikëqyrja e aktiviteteve do të thotë proces ku një autoritet i bën vërejtje agjentit të përmbartimit në lidhje me metodat të tij ose të saj të punës (probleme në planifikim, mungesa e mirësjelljes, etj); kjo është një lloj kontrolli i thjeshtuar që nuk ka të bëjë me shqyrtimin aktual të një ankese, por qëllimi i së cilit është që të garantojnë administrimin e drejtë të drejtësisë (shih Kontrolli i aktiviteteve).

*Pala e tretë:* As paditësi, as i padituri në procedurë.

*Transparenca e shpenzimeve të përmbartimit:* Informacioni mbi shpenzimet e përmbartimit duhet të jetë lehtësisht i qasshëm. Transparenca është një tregues i rëndësisë së ndërmarrjes së veprimeve (q.v) dhe nuk duhet të ngatërrohet me parashikueshmërinë (q.v).



---

[1] Në këtë kontekst, përmbendet numri i rëndësishëm I çështjeve të paraqitura para GJEDNJ duke theksuar problemet e ndryshme të përbarimit në shumë vende, veçanërisht në çështjet civile kundër shtetit ose ndërmarrjeve shtetërore, dhe kompleksitetin e veprimeve korrigjuese të kërkuara, duke përfshirë p.sh. thjeshtimet e procedurave të përbarimit, përmirësimi i procedurave buxhetore dhe kontrolli i brendshëm, përmirësimi i mundësive të ngrirjes ose sekuestrimit të llogarive ose pasurive të tjera të autoriteteve ose kompanive të pazgjedhura, funksionimi i shërbimeve të përbarimit. Shumë nga këto probleme ndiqen në kontekstin e mbikëqyrjes së Komitetit të Ministrave mbi mbikëqyrjen e vendimeve të GJEDNJ.

[2] J. LHUILLIER, D. LHUILLIER-SOLENIK, G. NUCERA, J. PASSALACQUA, Përbarimi i vendimeve gjyqësore në Evropë, Studimet CEPEJ Nr. 8, Këshilli i Evropës, 2008, 140 f.

[3] Rekomandimi Rec (2003) 16 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi përbarimin e vendimeve administrative dhe gjyqësore në fushën e së drejtës administrative; Rekomandimi Rec (2003) 17 i Komitetit të Ministrave për vendet anëtare mbi përbarimin.

[4] CEPEJ GT-EXE është i përbërë si më poshtë: Z. Andrei ABRAMOV (Rusi), Z. Karl-Heinz BRUNNER (Gjermani), Z. Fokion GEORGAKOPOULOS (Greqi), Z. Geert LANKHORST (Hollandë), Znj Ana LOVRINOV (Kroaci) , Z. John Marston (Mbretëria e Bashkuar). Më poshtë kanë marrë pjesë gjithashtu në takimet e Grupit: Z. John STACEY (Mbretëria e Bashkuar) dhe Z. Georg STAWA (Austri) për CEPEJ dhe Z. Léo NETTEN dhe Z. Mathieu CHARDON për Unionin Ndërkombëtar të Përbaruesve Gjyqësorë (UIHJ).

[5] CEPEJ mund të ketë për detyrë krijimin e një grupi pune për trajnimin mbi përbarimin, i përbërë nga praktikues, instruktorë dhe përfaqësues të shteteve anëtare ose organizatave ndërkombëtare.

[6] Nën kujdesin e Këshillit të Evropës dhe ndoshta në bashkëpunim me organizata të tjera ndërkombëtare, CEPEJ mund të caktohet për të identifikuar të dhënat që do të mblidhen.

[7] Konventa e Këshillit të Evropës për Qasjen në Dokumentet Zyrtare (CETS Nr. 205 - e hapur për nënshkrim në Qershor 2009 por jo ende në fuqi).

[8] Këshilli i Evropës, nëse është e mundur, së bashku me Bashkimin Evropian, mund të ndihmojë në këtë detyrë.